

**KONTRATE ADERIMI
E PUNEDHENESIT ME INSTITUTIN AMERIKAN TE PENSIONEVE PRIVATE
SUPLEMENTARE TE SHQIPERISE**

Mbështetur në nenet 23 dhe 24 të Ligjit nr. 7943, datë 01.06.1995 "Për pensionet suplementare dhe Institutet Private të Pensioneve Suplementare (i ndryshuar) si dhe në Rregulloren "Për Përfitimet Suplementare të të Siguruarve" të Institutit Amerikan të Pensioneve Private Suplementare të Shqipërisë

Sot, në Tiranë, më datë/...../2007, lidhet kjo kontratë midis palë të mëposhtme:

❖ **INSTITUTI AMERIKAN I PENSIONEVE PRIVATE SUPLEMENTARE TE SHQIPERISE**, sh.a i krijuar sipas legjislacionit shqiptar, i licencuar nga Inspektoriati i Instituteve Private të Pensioneve Suplementare, me lejen nr. 2, datë 07.07.2005, regjistruar në Regjistrin Tregtar me vendimin nr. 33825, datë 18.07.2005, të Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë, me seli në adresën: Rr. Mustafa Matohiti, Pal. 11/k, Kati 2, Zyra nr.1, Tirane, (më poshtë i quajtur "IAPPSSH"), i përfaqësuar nga Z. Arian Kraja, Drejtor i Përgjithshëm.

Dhe

❖ **PUNEDHENESI** :,me seli ne adresen.....
.....(me poshte i quajtur "Punedhenesi"),
perfaqesuar nga Z.

**NENI 1
OBJEKTI**

Objekt i kontratës është aderimi për të siguruar me pensione suplementare punëmarrësit e subjektit mbi atë çka garantohet nga skema e sigurimit të detyrueshëm shoqëror.

**NENI 2
TE DREJTAT DHE DETYRIMET E PUNEDHENESIT**

- 2.1 Punëdhënësi siguron në IAPPSSH punëmarrësit e tij sipas listës bashkëlidhur kësaj kontrate. Në listën e të siguruarve përcaktohet kontributi mujor i derdhur nga punëdhënësi në favor të punëmarrësit, sipas kushteve të përcaktuara në marrëveshje midis tyre.
- 2.2 Kontributi mujor i punedhenesit do te jete në masëntë pagës bruto të të siguruarit te percaktuar ne kontraten e punes, ose (.....) leke ne muaj .
- 2.3 Punedhenesi do te derdhe kontribute per sigurimin e punemarresve edhe per muajt perpara lidhjes se kontrates ne masentë pagës bruto të të siguruarit ose (.....) leke ne muaj per nje periudhe muaj.
- 2.4 Kontributet që derdhen nga punëdhënësi, së bashku me pjesën që derdh i siguruari, do të kalohen në llogarinë e IAPPSSH, nga Punëdhënësi ne fund te cdo muaji kalendarik per te cilin paguhen kontributet..
- 2.5 Punëdhënësi do të paraqesë çdo muaj në IAPPSSH listëpagesën, në të cilën pasqyrohen gjeneralitetet e punëmarrësve, të cilët kanë paguar kontributin mujor suplementar si dhe masa e kontributit mujor suplementar e paguar për çdo punëmarrës.

**NENI 3
TE DREJTAT DHE DETYRIMET E IAPPSSH**

- 3.1 IAPPSSH siguron mbrojtjen dhe investimin e sigurtë të fondeve, mbështetur në kuadrin ligjor dhe në rregulloren financiare të tij.
- 3.2 IAPPSSH, në përputhje me kuadrin ligjor merr përsipër të administrojë me efektivitet mjetet financiare, në mënyrë që të maksimizojë kthimin për përfituesit.
- 3.3 IAPPSSH, nisur nga parimi i transparencës, merr përsipër të informojë rregullisht të gjithë të siguruarit një herë në tre muaj në lidhje me gjendjen e llogarisë së tyre, dhe më konkretisht për

madhësinë e kontributeve të derdhura nga çdo i siguruar dhe punëdhënësi respektiv, si dhe nivelin e interesit të përfituar për secilën prej tyre.

NENI 4

KOHEZGJATJA E KONTRATES

Në përputhje me vullnetin e të dyja palëve, kontrata mund të rishihet çdo vit.

NENI 5

RASTET DHE KUSHTET E ZGJIDHJES SE KONTRATES

5.1. Punëdhënësi ka të drejtë të zgjidhë kontratën e aderimit me IAPPSSH, në rastin kur ai apo instituti i pensioneve shpërbëhen.

a) Në rastin kur shpërbëhet Punëdhënësi, punëmarrësit kanë të drejtë të vazhdojnë të jenë të siguruar në institutin e pensioneve (nëse ai nuk është shpërbërë), përkundërt lidhjes së një kontrate individuale me të;

b) Në rastin kur shpërbëhet IAPPSSH, llogaritë individuale të punëmarrësve do të transferohen në një institut tjetër privat të pensioneve suplementare, me të cilin punëdhënësi do të lidhë kontratë aderimi. Transferimi do të bëhet në përputhje me ligjin dhe rregulloren e IAPPSSH.

5.2. Kontrata mund të zgjidhet përjashtimisht përpara afatit nga Punëdhënësi, pas një njoftimi me shkrim të bërë 3 muaj përpara. Kontrata nuk mund të përfundojë përpara datës në të cilën punëdhënësi ka për të paguar të gjitha kontributet e tij në IAPPSSH.

NENI 6

TE NDRYSHME

6.1 Për sa nuk parashikohet në këtë kontratë, do të zbatohen dispozitat e parashikuara në Rregulloren e Pensioneve të Siguruesit dhe legjislacioni shqiptar për sa nuk parashikohet në Rregulloren në fjalë. Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis palëve të kësaj kontrate dhe që nuk zgjidhet në mirëkuptim mes tyre, do të zgjidhet nga Gjykata e Shkallës së Parë, Tiranë, vendimi i së cilës është i ankimueshëm sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë.

6.2 Ndryshimi i kushteve të kësaj kontrate mund të bëhet vetëm me shkrim dhe të nënshkruhet nga të dyja palët, në të kundërt është i pavlefshëm.

NENI 7

DISPOZITA PER FUNDIMTARE

Kontrata hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të saj nga palët.

Kjo kontratë hartohet dhe nënshkruhet në 2 (kopje), me të njëjtën vlerë secila.

**INSTITUTI AMERIKAN I PENSIONEVE
PRIVATE SUPLEMENTARE TE SHQIPERISE**

PUNEDHENESI

Perfaqësuar nga

Perfaqësuar nga

**Arian KRAJA
DREJTOR I PERGJITHSHEM**

.....
.....